



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 289 prot.

Tiranë, më 26/11 /2024

Lënda: Raport informues për përdorimin propagandistik të dëshmorëve nga ana e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe mbrojtja që i bëhet kësaj propagande me Ligjin nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”

KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Znj. Elisa Spiropali

KOMISIONIT PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK
Znj. Ina Zhupa

Gjatë punës së tyre studimore, kërkuesit shkencorë të ISKK kanë gjetur dokumente që dëshmojnë se regjimi komunist e përdori konceptin e dëshmorit të atdheut si një instrument propagandistik për interesa politike të tij. Këto dokumente – vendime, ligje, udhëzime, të cilat dëshmojnë si Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH) i përdori të rënët në luftë për qëllimet e saj, duke e ideologjizuar konceptin e dëshmorit, prezantohen në këtë raport së bashku me një analizë dhe kontekst historik. Në raport argumentojmë gjithashtu se koncepti i dëshmorit ideologjik i krijuar nga PPSH vazhdon të jetë i mbrojtur nga Ligji nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut.” Në fund raporti mbyllet me disa rekomandime për Kuvendin e Shqipërisë.

BAZA LIGJORE

ISKK është krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri". Detyrat kryesore të ISKK, parashikuar në këtë ligj, janë:

Neni 5:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;*
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;*
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;*
- ç) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;*
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;*
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;*
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;*
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;*
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;*
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;*
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;*

h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;

j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;

k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.

QËLLIMI

Ky raport ka për qëllimin informimin e Kuvendit të Shqipërisë për përdorimin propagandistik nga regjimi komunist të konceptit të dëshmorit të atdheut dhe mbrotjen që i bëhet kësaj propagande me Ligjin Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

OBJEKTI

Objekti i këtij raporti janë politikat e regjimit komunist lidhur me konceptin e dëshmorit të atdheut dhe Ligji Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në dokumente të periudhës së regjimit komunist. Metoda e përdorur për hartimin e tij është kërkimi arkivor, përshkrimi, krahasimi dhe analiza e dokumentit.

Dokumentet janë autentike të prodhuar nga organet e regjimit komunist: Byroja Politike e KQ të PPSH, KQ i PPSH, dhe Kuvendi Popullor.

Dokumentet kryesore ku bazohet raporti janë:

- Vendimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 228, 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm”;
- Vendimi i KQ të PPSH, Nr. 114, datë 7.7. 1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm”;
- Dekreti Nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut”;
- Udhëzimim “Mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre” (pa datë, krijuar njëkohësisht me Dekretin Nr. 4558, si pjesë shpjeguese e tij).
- Ligji nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.

Raporti bazohet në dokumente origjinale, të botuara në organe zyrtare, ose përmbledhje dokumentare.

BURIMI DHE AUTENTICITETI I DOKUMENTEVE

Aspekti kyç i një dokumenti është origjinaliteti i tij. Dokumentet ku bazohet ky raport janë autentike dhe të verifikueshme. Disa gjenden vetëm në arkivë, disa gjenden në arkivë dhe të botuar në formate të ndryshme.

- Vendimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 228, 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm”, ka këtë referencë arkivore: AQSH, F. 14/APOU, V. 1959, D. 19, Fl. 24-38. Dokumenti është i nënshkruar nga Enver Hoxha, sekretar i parë i PPSH. Ky dokument është krijuar bazuar në “Raport mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm,” nënshkruar nga Nexhmije Hoxha, drejtore e Drejtorisë së Arsim-Kulturuës, dhe Liri Belishova, sekretare e KQ të PPSH; data e daktilografimit të raportit 24.6.1959. Raporti është prezantuar në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH, 7.7.1959. Po atë ditë është prezantuar dhe vendimi i Byrosë. Akademia e Shkencave, në *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar* (1985),¹ i referohet vendimit të Byrosë Politike si akt normativ për datën 5 maj si ditë e dëshmorëve, dhe jo vendimit të KQ, duke përcjellë dhe perceptimin e saj për hierarkinë e organeve drejtuese të PPSH.
- Vendimi i KQ të PPSH, Nr. 114, datë 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm” është identik me Vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 228, 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm.” Në ditën e daljes së dokumentit nuk ka gjurmë që është mbledhur KQ i PPSH; ai mbledhej 2-3 herë në vit dhe mbledhjet e tij quheshin plenum. Me sa duket, vendimin e saj, Byroja Politike, e ka nxjerrë dhe si vendim të KQ. Në këtë rast, dokumenti i KQ të PPSH tregon se KQ nuk ishte organi më i lartë i PPSH, siç pretendohet, por ai zbatonte urdhërat e Byrosë Politike të tij. Pra, ky dokument tregon se organi më i lartë vendimarrës në PPSH ishte Byroja Politike, dhe për qëllimet e këtij raporti ne do t’i referohemi vendimit të Byrosë Politike, pavarësisht se më 1959, kur dolën këto dy vendime, u publikua vetëm vendimi i KQ. Vendimi i KQ të PPSH, Nr. 114, datë 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm” u botua në gazetën *Zëri i Popullit*, 10.10.1959, Nr. 2018 (3433). Më 1970, ky vendim u botua në përmbledhjen e dokumentare “PPSH: dokumente kryesore”, vëllimi III, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, fq. 245-251.
- Dekreti Nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut”, ka këtë referencë arkivore: AQSH, F. 4889, V. 1969, D. 62, Fl.10-11. Dokumenti është origjinal, nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit Popullor, Haxhi Lleshi, dhe sekretari Bilbil Klosi.

¹ Fjalori Enciklopedik Shqiptar (Trianë: Akademia e Shkencave, 1985), 822.

Ky dekret është shfuqizuar me Ligjin Nr. 8607, datë 27.04.2000, “Statusi i dëshmorit të atdheut.”

- Udhëzimim “Mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre”. Ky dokument ka të njëjtin burim arkivor me Dekretin Nr. 4558, gjenden në të njëjtën dosje: AQSH, F. 4889, V. 1969, D. 62, Fl.12-17. Ky dokument është krijuar në të njëjtën kohë me Dekretin, i projektuar si një manual shpjegues për të lehtësuar zbatimin e Dekretit, i cili kishte një formulim lakonik për konceptin e dëshmorit. Udhëzimi nuk ka datë, por ai është krijuar në të njëjtën kohë me dekretin, dhe data e dekretit duhet të jetë dhe data e tij. Kjo kuptohet nga letra e Kuvendit Popullor, Nr. prot. 102, datë 6.10.1969, drejtuar komiteteve ekzekutive të rretheve, ku thuhet: “Bashkangjitur ju dërgojmë projekt-dekretin “Mbi dëshmorët e Atdheut”, bashkë me udhëzimin përkatës, me qëllim që të studjohet nga ana jua dhe të bëni vërejtje.”²
- Ligji nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Ky ligj gjendet në Fletoren Zyrtare, nr. 197, publikuar më 15 janar 2019. (burimi: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/197/c296680f-0015-4e9c-8bef-76fb6f7bb626;q=Ligji%20nr.%20109%2F2018,%20>)

PËRMBAJTJA VENDIMI NR. 228, DATË 7.7.1959, I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH

Vendimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH Nr. 228, 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm,” e trajton gjerë çështjen e traditave, por për qëllimet e këtij raporti ne do të trajtojmë vetëm çështjen e dëshmorëve.

Pika 8 e vendimit nr. 228, thotë: “Me qëllim që dëshmorët e luftës të përkujtohen nga gjithë populli, të caktohet si ditë pelegrinazhi në varrezat e tyre – 5 Maji – dita e vrasjes së Qemal Stafës. Në këtë ditë nëpër varrezat e dëshmorëve të organizohen pelegrinazhe masive, metingje dhe të mbahen minutat e heshtjes në shenjë nderimi të kujtimit të tyre. Këtë ditë varrezat të zbukurohen në mënyrë të veçantë me lule etj. dhe të kenë roje nderi nga pionierë, të rinj dhe punonjës të tjerë. Gjithashtu në këtë ditë të organizohen kudo vizita nëpër familjet e dëshmorëve. Përveç kësaj dite, për të mbajtur gjallë kujtimin e të rënëve në luftë, në përvjetorët e vrasjes së dëshmorëve të organizohen roje nderi pranë busteve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, ose varrezave të tyre.

Komitetet e partisë, komiteteet ekzekutive dhe Drejtoria komunale të tregojnë më tepër kujdes për mirëmbajtjen dhe zbukurimin e varrezave të dëshmorëve. Lidhur me këtë brenda muajit dhjetor të këtij viti Kryeministria të lëshojë një udhëzim të posaçëm.

² AQSH, F. 489, V. 1969, D. 62, Fl. 2.

Komitetet ekzekutive, në bashkëpunim me Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës dhe me Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve, në bazë të një plani prespektiv, të ngrejshë në varrezat e dëshmorëve monumente.

Veçanërisht në fshatrat, ku ka varre të patriotëve e të luftëtarëve të rënë në luftën për lirinë e Atdheut, të tregohet një kujdes i posaçëm për t'i grumbulluar dhe për t'i sistemuar. Kjo punë të përfundojë brenda muajit shkurt 1960."

PPSH ishte, formalisht, një organizatë politike, e cila nuk kishte autoritet ligjor për të nxjerrë akte detyruese në nivel kombëtar, megjithatë, me vendimin në fjalë, ajo bëri detyrues për gjithë popullin një direktivë të saj politike.

Gjatë regjimit komunist dita 5 maj u përkujtua si ditë e dëshmorëve bazuar në këtë vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe kishte kuptim, sepse të vrarët ishin në shumicë dërrmuese ish-partizanë, partizanët kishin qenë krah i armatosur i PKSH dhe asaj i takonte t'i nderonte. Kthimi i vendimit të PPSH në ligj, më 27 prill 2000 dhe 20.12.2018, prish kohezionin e qëndrimeve të Kuvendit ndaj regjimit komunist i shprehur përmes disa ligjeve dhe rezolutave tij.

PËRKUFIZIMI JURIDIK PËR DËSHMORIN GJATË REGJIMIT KOMUNIST

Përkufizimi për dëshmorin e atdheut u krijua me Dekretin nr. 4558, datë 18.10.1969, "Mbi dëshmorët e Atdheut". Sipas këtij përkufizimi, dëshmor i Atdheut quheshin:

- "a) Të gjithë ata që kanë dhënë jetën duke luftuar kundër armiqëve të jashtëm e të brëndshëm për lirinë, pavarësinë kombëtare, demokracinë ose për kauzën e proletariatit të vendeve të tjera;
- b) Të gjithë ata që kanë dhënë jetën për çlirimin e Atdheut dhe të popullit duke luftuar në forma të organizuara të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhëtarëve të vëndit gjatë periudhës 7 prill 1939 gjer më 29 nëndor 1944 dhe jashtë Atdheut gjer më 9 maj 1945;
- c) Të gjithë ata që kanë dhënë jetën në luftë e përpjekje me armiqtë e jashtëm e të brëndshëm për mbrojtjen e kufijve të Atdheut, për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor."

Siç shihet, dëshmori i përkufizuar nga dekreti nr. 4558 është një dëshmor ideologjik. Ai nderohet se ka dhënë jetën "për kauzën e proletariatit të vendeve të tjera", "për çlirimin e Atdheut dhe të popullit duke luftuar në forma të organizuara të Lëvizjes Nacional-Çlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë dhe tradhëtarëve të vëndit", duke luftuar "jashtë Atdheut", dhe "për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor".

Ky dekret u shfuqizua me nenin 21, të Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000, "Statusi i dëshmorit të atdheut."

PËRKUFIZIMI IDEOLOGJIK I DËSHMORIT NË UDHËZIMIN "MBI DËSHMORËT E ATDHEUT DHE VARREZAT E TYRE"

Ideologjizimi i konceptit të dëshmorit gjatë regjimit komunist filloi që në ditët e para të tij, e ndoshta dhe më herët, që gjatë luftës, por ne do t'ju referohemi dokumenteve zyrtare, të cilat ishin akte detyruese, të nxjerra nga organi më i lartë ligjbërës. Gjurmët e ideologjizimit të konceptit të dëshmorit shfaqen në Dekretin nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut”, me përdorimin e termave “proletar”, “lëvizje nacionalçlirimtare”, “kauzë e proletariatit”, revolucion popullor”, por më të qarta ato shfaqen në udhëzimin “Mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre,” datë 18.10.1969.

Qëllimi i krijimit të udhëzimit ishte lehtësmi i procesit të zbatimit të Dekretin nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut”.

Bazuar në dokumentin “Udhëzimin mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre”, regjimi komunist i ndante dëshmorët në tre grupe, të gjithë të lidhur me Luftën Nacionalçlirimtare:

1. Dëshmori i “periudhës para luftës Nacional-Çlirimtare”
2. Dëshmori i “Luftës Nacional-Çlirimtare”
3. Dëshmori i “pas çlirimit”

Lufta Nacionalçlirimtare, lufta e forcave të armatosura të PPSH, ishte vija ndarëse në historinë e Shqipërisë e këqyrur me lentet e komunizmit.

Dëshmori i llojit të parë i përkiste periudhës parakomuniste, por selektimi bëhej nga këndvështrimi komunist, duke përdorur si instrument ndarjen klasore të supozuar, sepse, në realitet, ndarja klasore nuk ishte realitet juridik. Përkufizimi i dëshmorit të llojit të parë është: “Quhen dëshmorë të periudhës para luftës Nacional-Çlirimtare të gjithë ata persona që kanë dhënë jetën në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe reaksionit të brendshëm para 7 prillit të vitit 1939.”

Koncepti “reaksion i brendshëm” ishte koncept ideologjik, i cili buronte nga qasja marksiste e ndarjes së shoqërisë në klasa, megjithëse vetë shoqëria në kohën e dhënë nuk funksiononte bazuar në vetëdijen marksiste klasore.

Dëshmori ideologjik i llojit të dytë ndahet në disa nënllaje:

1. Te nënllaji i parë dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë luftuar në forma të organizuara kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe tradhtarëve të vendit për çlirimin e Atdheut, lirinë e popullit dhe vendosjen e pushtetit popullor duke marrë pjesë në radhët e reparteve dhe njësive partizane të rregullta të Ushtrisë nacional-çlirimtare, dhe janë vrarë nga armiku ose kanë vdekur para 29 nëndorit të vitit 1944 nga plagët e marra në luftë.”
Terma ideologjike: ushtri nacionalçlirimtare. **Terma propagandistike:** tradhtar i atdheut, çlirim i atdheut, liri e popullit.
2. Te nënllaji i dytë i dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë luftuar në forma të organizuara kundër pushtuesve italianë e gjermanë dhe tradhtarëve të vendit për çlirimin e Atdheut, lirinë e popullit dhe vendosjen e pushtetit popullor duke marrë pjesë në radhët e reparteve dhe njësive të tjera luftonjëse, territoriale ose ilegale, të Luftës Nacional-

Çlirimare dhe janë vrarë nga armiku ose kanë vdekur para 29 nëntorit të vitit 1944 nga plagët e marra në luftë.”

Terma ideologjikë: ushtri nacionalçlirimtare. **Terma propagandistikë:** tradhtar i atdheut, çlirim i atdheut, liri e popullit.

3. Te nënloji i tretë i dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë qenë pjesëtarë të organeve drejtonjëse të Partisë Komuniste (anëtarë të komiteteve të rajoneve, qarqeve apo të Komitetit Qendror të Partisë), të organizatës së Frontit nacional-çlirimtar (anëtarë të këshillave të fshatrave, rajoneve, qarqeve apo Këshillit të Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar), të organizatës së Rinisë, të Gruas, etj., të cilët janë vrarë...”

Terma ideologjikë: parti komuniste, front nacionalçlirimtar, këshill (i përgjithshëm) nacionalçlirimtar, organizatë e rinisë, organizatë e gruas.

4. Te nënloji i katërt i dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë qenë anëtarë të Partisë Komuniste Shqiptare ose anëtarë të Frontit nacional-çlirimtar dhe të organizatave që përfshiheshin në të (organizata e Rinisë, e Gruas, etj.) të cilët janë vrarë nga armiku duke luftuar me armë në dorë kundër tij në krye të detyrës, edhe duke mos qenë të inkuadruar në radhët e forcave partizane, ose janë kapur me forcë ose tradhëtisht nga armiku dhe janë vrarë prej tij ose kanë vdekur prej torturave të armikut.”

Terma ideologjikë: parti komuniste, front nacionalçlirimtar, organizatë e rinisë, organizatë e gruas. **Terma propagandistikë:** në krye të detyrës.

5. Te nënloji i pestë i dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë qenë të organizuar në Lëvizjen nacional-çlirimtare ose në Partinë Komuniste Shqiptare dhe janë kapur me forcë ose tradhëtisht nga armiku dhe kanë vdekur në burg ose në internim përpara 29 nëntorit 1944.”

Terma ideologjikë: lëvizje nacionalçlirimtare, parti komuniste.

6. Te nënloji i gjashtë i dëshmorit ideologjik futen ata që “kanë dhënë jetën në luftën kundër fashizmit jashtë tokave të Atdheut gjatë periudhës 7 prill 1939 gjer më 9 maj 1945.”

Terma propagandistikë: luftë kundër fashizmit.

PËRKUFIZIME IDEOLOGJIKE PËR TË TERMA TË PËRDORUR NË DEKRETIN NR. 4558, DATË 18.10.1969, “MBI DËSHMORËT E ATDHEUT”

Në vijim por japim kuptimin e termave ideologjikë të përdorur në Dekretin nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut” dhe në udhëzimim “Mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre,” datë 18.10.1969. Përkufizimi i tyre është dhënë kryesisht bazuar në përkufizimin e përdorur në botimet e Akademisë së Shkencës, botime të periudhës së regjimit komunist.

PROLETAR (emër): Punëtor me mëditje në shoqërinë kapitaliste, i cili nuk ka asnjë mjet prodhimi, nuk zotëron asgjë tjetër përveç fuqisë së krahut, që është i detyruar t'ia shesë kapitalistit për të mos vdekur nga uria; pjesëtar i klasës së proletariatit. *Proletarët e qytetit (e fshatit). Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!*

PROLETAR (mbiemër/1): Që ka të bëjë me proletariatin, i proletarëve ose i proletariatit; që përbehet nga proletarët ose mbron interesat e proletariatit; që është karakteristik për proletarët, që frymëzohet nga idealet e proletariatit dhe i pasqyron ato. *Parti proletare. Familje proletare. Ideologji proletare. Partishmëri (frymë) proletare. Botëkuptim proletar. Disiplinë proletare. Heroizëm proletar. Thjeshtësi (ndërgjegje) proletare. Moral (himanizëm) proletar. Virtyte proletare. Arti proletar. Letërsi (kulturë) proletare. Internacionalizëm proletar. Me prejardhje proletare.*

(2): Që zhbuk pronën private mbi mjetet e prodhimit dhe e shndërron atë në pronë të gjithë shoqërisë, që shkull nga rrënjët shfrytëzimin e njeriut nga njeriu dhe e vë proletariatin në krye të pushtetit shtetëror; që është në dobi të proletariatit, që u shërben qëllimeve të proletariatit. *Revolucion proletar. Politikë (vijë) proletare. Diktaturë proletare. Demokracia proletare është demokraci e vërtetë.*

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 1556)

NACIONALÇLIRIMTAR: Që bëhet për të çliruar vendin nga pushtuesit e huaj; që ka të bëjë me luftën kombëtare të një populli a të një vendi për tu çliruar nga pushtuesit e huaj. *Lëvizje nacionalçlirimtare. Lufta Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar. Ushtria Nacionalçlirimtare. Këshillat nacionalçlirimtare. Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar.*

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 1195)

LËVIZJA NACIONALÇLIRIMTARE: Një emërtim i përdorur nga marksistët për përpjekjet e kolonive dhe vendeve të tjera të varura për të arritur pavarësinë nga dominimi dhe shfrytëzimi imperialist. Në kulmin e imperializmit, para Luftës së Parë Botërore, më shumë se 2/3 e botës përfshiheshin në këtë kategori. Lëvizjet nacionalçlirimtare të përgjithshme dhe sistematike nisën pas Luftës së Dytë Botërore, sidomos në mesin e viteve 1950.

Lëvizjet nacionalçlirimtare u sanksionuar fillimisht nga Internacionalja e Parë dhe u mbështetën hapur në dokumentin “Njëzet e një kushte për t’u pranuar në Komintern”, miratuar më 1921. Por deklarata marksiste më e plotë u përfshi në dokumentin e njohur si “Teza mbi Çështjen Koloniale dhe Kombëtare”, i shpallur në Kongresi e 6-të të Kominternit më 1928, me anë të të cilit proletariatit i bëhej thirrje të mbështeste lëvizjet nacionaliste të borgjezisë në lëvizjet nacionalçlirimtare...

(Burimi: Jozef Wilczynski, *An Encyclopedic Dictionary of Marxism, Socialism and Communism* (London and Basingstoke: The Macmillan Press LTD, 1981), 378.)

PARTI KOMUNISTE: Reparti pararojë dhe i organizuar i klasës punëtore që e udhëheq atë drejt fitores së revolucionit proletar dhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste, që ka në themel të gjithë veeprimtarisë së saj idetë e marksizëm-leninizmit...

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 1372)

KËSHILL (I PËRGJITHSHËM) NACIONALÇLIRIMTAR: Organ lufte dhe i pushtetit popullor gjatë Luftës Nacionalçlirimtare.

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 827)

FRONT NACIONALÇLIRIMTAR: Organizatë politike e masave... që u krijua... nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë...

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 504)

ORGANIZATË E RINISË: Reparti i organizuar i i masave revolucionare të rinisë së RPS të Shqipërisë, ndihmës besnik dhe rezervë luftarake e PPSH.

(Burimi: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1985, fq. 782)

ORGANIZATË E GRUAS: Është organizata politike masive, revolucionare që bashkon me vullnet të lirë masat e gjera të grave në luftë për ndërtimin e socializmit...

(Burimi: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1985, fq. 782)

Organizata e Frontit, Gruas dhe Rinisë, quheshin organizata të masave, të cilat kishin një përkufizim të përbashkët: Organizata politike shoqërore... pjesë e rëndësishme e sistemit të diktaturës së proletariatit, leva të fuqishme të lidhjes së PPSH me masat punonjëse. Gjithë veprimtarinë e tyre organizatat e masave e zhvillojnë nën udhëheqjen e në bazë të direktivave të PPSH.

(Burimi: *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1985, fq. 782)

PËRKUFIZIME PROPAGANDISTIKE PËR TERMA TË PËRDORUR NË DEKRETIN NR. 4558, DATË 18.10.1969, “MBI DËSHMORET E ATDHEUT”

TRADHTAR: Ai që del kundër atdheut, popullit, Partisë etj., duke u bashkuar me armikun, duke bashkëpunuar me të ose duke bërë punën e tij; ai që bëhet armik, duke kryer veprimtari spiunazhi kundër popullit a vendit të vet, duke nxjerrë të fshehta të rëndësishme, duke u arratisur në një vend tjetër etj.; ai që nuk u qëndron besnik parimeve, ideve a një çështjeje të madhe; ai që shkel betimin, ai që tradhton. *Tradhtarët e popullit (e atdheut). Tradhtarët e klasës punëtore. Tradhtarët revizionistë.*

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 2010-2011)

BANDË (2): Grup njerëzish të bashkuar për të bërë vjedhje, plaçkitje e krime; grup njerëzish, zakonisht në pushtet, që vepron në dëm të popullit me metoda kriminelësh e tradhtarësh. *Bandë e armatosur. Bandë balliste (reaksionare). Bandë diversantësh (hajdutësh, kriminelësh, tradhtarësh). Bandë të arratisurish. Kreu i bandës. Asgjësuan bandën.*

(Burimi: *Fjalorit të Gjuhës Shqipe*, Akademia e Shkencave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1980, fq. 94)

Koment: PKSH nuk kishte asnjë autoritet juridik të përcaktonte kush ishte tradhtar ose bandë. Ajo dhe njësitë e saj ushtarake ishin juridikisht me të njëjtin status si Balli Kombëtar, Legaliteti, dhe çetat e tyre. Nëse çetat balliste ishin tradhtarë, ose banda, atëherë edhe çetat komuniste ishin tradhtarë dhe banda.

Ilustrim me formulë nga shkencat ekzakte : PKSH (a) ishte juridikisht e barabartë me Ballin Kombëtar (b). Balli kombëtar (b) ishte i barabartë me tradhtar (c). Përfundimi: PKSH (a) ishte e barabartë me tradhtar (c).

MBROJTJA E POLITIKAVE TË REGJIMIT KOMUNIST ME LIGJIN NR. 109/2018, “PËR STATUSIN E DËSHMORIT TË ATDHEUT”

1.

Pas rënies së komunizmit, Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar ligje që mbrojnë politikën e regjimit komunist për çështjen e dëshmorëve.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 8607, datë 27.04.2000, “Statusi i dëshmorit të atdheut”, i cili mbron dëshmorin ideologjik, sipas vizionit të PPSH. Neni 3 i këtij ligji sanksiononte që:

“Të gjitha vendimet e mbështetura në ligjet ose dekretet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen “Dëshmor”, nuk janë objekt rishikimi. Personi i rënë në luftë dhe i shpallur “Dëshmor” konsiderohet “Dëshmor i Atdheut” në kuptim të këtij ligji.”

Hartuesit e ligjit e kishin të qartë që me këtë dispozitë ligjore ata mbronin vendimet e dala në mbështetje të ligjeve dhe dekreteve të regjimit komunist, sepse, me nenin 21 të këtij ligji ata shfuqizuan Dekretin Nr. 4558, datë 18.10.1969, “Mbi dëshmorët e Atdheut.”

Më 2018, Kuvendi i Shqipërisë hartoi një ligj të ri për dëshmorët, Ligjin Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, i cili vazhdon ta mbrojë dëshmorin ideologjik me nenin 7 të tij, i cili sanksionon: *“Të gjitha dekretet/vendimet e organeve shtetërore për shpalljen “Dëshmor”, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë objekt rishikimi nga ky ligj.”*

Pra, çdo vendim për statusin e dëshmorit i dhënë gjatë regjimit komunist nuk mund të rishikohet, edhe nëse gjenden fakte që ai status mund të jetë dhënë bazuar në dokumente të falsifikuara, etj. Referuar dokumentit “Raport për projektligjin “Për statusin e dëshmorit të Atdheut”, datë 17.12.2018, “Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 17.12.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për statusin e dëshmorit të atdheut”. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji një person, i cili gjatë regjimit komunist ka qenë pjesëtar i organeve të diktaturës, të cilat përkufizohen në pikën ç, neni 3, të Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”.

2.

Gjatë regjimit komunist, 5 maji respektohej si ditë e përkujtimit të dëshmorëve, e caktuar me Vendimin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, Nr. 228, 7.7.1959, “Mbi traditat patriotike-revolucionare të popullit tonë dhe masat për njohjen dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm.” Bazuar në këtë vendim, 5 maji u përkujtua si ditë dëshmorësh deri më 27 prill 2000. Me krijimin e Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000, “Statusi i dëshmorit të atdheut”, vendimi i Byrosë Politike të KQ të PPSH për kujtimin e datës 5 maj si ditë e dëshmorëve u ngrit në nivel ligji. Neni 6 i këtij ligji sanksionoi që: “Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut është 5 Maji.”

Ndryshe nga vendimi i Byrosë Politike, ligji nuk e përmendte faktin që 5 maji ishte data e vrasjes së Qemal Stafës, ish-anëtar Komitetit Qendror të Përkohshëm të PPSH, dhe, për rrjedhojë, person me kontribute në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri.

Ligjit Nr. 8607, datë 27.04.2000, “Statusi i dëshmorit të atdheut” u abrogua më 20 dhjetor 2018, por vendimi i Byrosë Politike që 5 maji, dita e vrasjes së një komunisti, të jetë ditë e përkujtimit të dëshmorëve është në fuqi. Neni 16, i Ligjit Nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, sanksionon që: “Dita përkujtimore e Dëshmorëve të Atdheut është 5 Maji.”

Personit në kujtim të të cilit përkujtohet 5 maji ia ka dhënë statusin e dëshmorit regjimi komunist dhe ky vendim mbrohet me Ligjin nr. 10/2018, se përndryshe atij nuk i takon ky status. Qemal Stafa nuk ka qenë pjesë e asnjë formacion ushtarak antifashist dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë betejë kundër ushtrive pushtuese. Sipas Akademisë së Shkencave, atributi kryesor i Qemal Stafës, për t’u përfshirë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1985), ishte që ka “qenë një militant

komunist, bashkëpunëtor i ngushtë i diktatorit Enver Hoxha.” Ndërsa Kuvendi i Shqipërisë ka dhënë këtë vlerësim për Enver Hoxhën dhe regjimin që ai ngriti me mbështetjen e njerëzve si Qemal Stafa, në rezolutën “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri,” 30.10.2006:

- *Regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës dhe klikës së tij, që qeverisi Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990, u karakterizua nga: dhunimi masiv i të drejtave të njeriut, vrasjet dhe ekzekutimet individuale e kolektive (me dhe pa gjyq), vdekjet në kampet e përqendrimit, vdekjet nga uria, torturat, dëbimet, puna skllavëruese, terrori fizik dhe psikologjik, gjenocidi për shkak të origjinës politike apo trashëgimisë së pronës, si dhe dhunime të lirisë së ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes, lirisë së shtypit, lirisë së besimit fetar dhe lirisë së pluralizmit politik. (pika 2 e Rezolut[s])*
- *Kuvendi i Shqipërisë dënon fuqimisht dhunimin masiv të të drejtave të njeriut të kryer nga regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës dhe klikës së tij. (pika 7)*
- *Kuvendi i Shqipërisë dënon diktatorin Enver Hoxha si ideatorin, frymëzuesin, drejtuesin dhe ekzekutuesin e sistemit më të egër diktatorial komunist në Europën Lindore, që çoi në izolimin dhe varfërimin e tejskajshëm të Shqipërisë dhe kërkon heqjen e të gjithë titujve dhe dekoratave të dhëna atij e bashkëpunëtorëve të tij nga regjimi komunist. (pika 8)*

3.

Dëshmorët jashtë atdheut janë dy kategori: dëshmorët e Spanjës dhe dëshmorët e rënë në ish-Jugosllavi.

Dëshmorët e Spanjës

Ata që shkuan në Spanjë, që thirren vullnetarë, ishin mercenarë të Bashkimit Sovjetik, dhe jo përfaqësues të shtetit shqiptar. Petro Marko, njëri prej këtyre mercenarëve, tregon në kujtimet e tij, se, kur u kthye nga Spanja në Francë, shkoi të takonte Ali Kelmendin për të marrë rrogat, por ai i kishte prishur në kumar.³ Rrogat i jepte Kominterni, që ishte një organizatë bolshevike, me qendër në Moskë, e kontrolluar nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Për të frenuar personat që shkonin në Spanjë, Parlamenti i Shqipërisë nxori ligjin “Mbi faje kontra rregullit shoqëruar dhe ekonomik dhe mbi ndalimin e rekrutimit për shërbime në shtete të huëj”, 14.04.1937, dekretuar 23.04.1937, botuar në *Fletoren Zyrtare*, nr. 32, datë 30.04.1937. Ata që luftuan në Spanjë kanë vepruar në shkelje të ligjeve të Atdheut.

Dëshmorët e Jugosllavisë

Ata që shkuan në Jugosllavi ishin partizanë; partizanët ishin krahu i armatosur i një partie politike të paligjshme; në Shqipëri kishte disa partia politike të paligjshme; secila përfaqësonte

³ Petro Marko, *Intervistë me vetveten: Retë dhe gurët* (Tiranë: OMSCA-1, 2000), 259.

një fragment të popullit shqiptar. Formacionet partizane të Shqipërisë që shkuan jashtë u përdorën për të nënshtruar popullsinë shqiptare që refuzonte pushtetin e PKJ në Kosovë. Kjo është vërtetuar tashmë në një nga veprat studimore të botuara nga ISKK: Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri*, 1943-1945, 2 vëllime, (2015). Po citojmë veç një fragment, nga letra e gjeneralit jugosllav Petko Dapçeviç, 3 mars 1944, për Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë partizane shqiptare: “Ju e dini që reaksioni prej Shqipërisë së Veriut, i udhëhequr prej Komitetit të Kosovës, na krijon vështirësina të mëdhaja dhe se ne gati për gjysmë viti mbajmë front kundrejt kufinit të ri të krijuem prej okupatorit të Shqipnis së Madhe... Na, sot disponojmë fuqina të plota dhe të armatosuna mirë dhe sigurisht do të marrim detyra të spastrimit të mëtejshëm të territorit dhe në krijimin e pushtetit dhe kështu konstatojmë: Asht e nevojshme që fuqinat tueja pjesërisht t’i orientoni në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosmet, me qëllim bashkëpunimin me forcat tona...”⁴

Ata që luftuan jashtë kufijve të Shqipërisë vepruan në shkelje të ligjit “Mbi fajë kontra regullit shoqëruer dhe ekonomik dhe mbi ndalimin e rekrutimit për shërbime në shtete të huej”, 14.04.1937, i cili ishte kthyer në fuqi nga Kuvendi Kombëtar, nr. 1, 22.10.1943.

PËRFUNDIME

1.

Dëshmorët e shpallur me vendime të institucioneve të regjimit komunist janë dëshmorë ideologjikë, që u përdorën nga regjimi komunist për interesat e tij politike. Ata përfaqësonin një rën anë të konfliktit civil që u zhvillua në Shqipëri në periudhën 1943-1944. Ata nuk përfaqësonin interesat e popullit shqiptar, veprimtaria e tyre nuk ishte në zbatim të një akti normativ të nxjerrë nga një autoritet që përfaqësonte vullnetin e popullit shqiptar. Ata vepronin nën urdhërat e PKSH, e cila vepronte nën urdhëra të një entiteti të huaj (jo shqiptar), siç ishte Kominterni, i cili nuk përfaqësonte në asnjë mënyrë vullnetin e popullit shqiptar.

2

Gjatë regjimit komunist 5 maji u përkujtua si ditë e dëshmorëve bazuar në një vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe kishte kuptim, sepse të vrarët ishin në shumicë dërrmuese ish-partizanë, partizanët kishin qenë krah i armatosur i PKSH dhe asaj i takonte t’i nderonte, por jo gjithë populli shqiptar. Ushtria partizane e dëmtoi popullin shqiptar më shumë se ushtria pushtuese italiane dhe gjermane, siç ju kemi informuar me shkresën nr. prot. 277, datë 19.11.2024, “Raport informues për identifikimin e viktimave të regjimit komunist në *Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist*, botim i Institutit të Studimeve për Krimet dhe

⁴ Uran Butka, *Lufta Civile në Shqipëri* (Tiranë: ISKK, 2015), 304.

Pasojat e Komunizmit”, duke i shkaktuar 2254 të vrarë. Detyrimi i gjithë popullit të përkujtonte dëshmorët partizanë bazuar në një vendim të Byrosë Politike të KQ të PPSH është një nga krimet dhe shkeljet ligjore të shumta të regjimit komunist. Vazhdimi i kësaj procedure, kur një pjese të popullsisë i duhet të nderojë vrasësit e 2254 familjarëve të tyre është një procedurë reminishente e diktaturës që nuk i bën asnjë nder Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk ndihmon në mbylljen e plagëve të së shkuarës dhe pajtimit kombëtar.

3

Kthimi i vendimit të PPSH në ligj, më 27 prill 2000, është rrjedhojë e mungesës së një ligji lustracioni në Shqipëri. Për këtë çështje ISKK i ka përcjellë Kuvendit rekomandimet përkatëse me shkresën nr. prot. 130, datë 02.09.2022, “Raport mbi studimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së PKSH/PPSH dhe rekomandime”.

REKOMANDIME

Në përfundim të këtij raporti informues, ISKK i rekomandon Kuvendit të Shqipërisë:

- Të abrogojë Ligjin nr. 109/2018, “Për statusin e dëshmorit të atdheut”.
- Të hartojë një ligj të ri për dëshmorët të pastruar nga fryma ideologjike komuniste në konsultim me ekspertët shkencorë të ISKK dhe institucione të tjera studimore.
- Në ligjin e ri të theksohet që statusi i dëshmorit jepet vetëm për persona që bëjnë sakrificën sublime duke qenë ligjërisht të vendosur në shërbim të atdheut.
- Të ndryshojë datën e përkujtimit të dëshmorëve me një datë të përcaktuar jo mbi kritere ideologjike (kjo dhe si detyrim që buron nga rekomandimi në pikën 8 të rezolutën “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri,” 30.10.2006).
- T’u japë të njëjtin status të gjithë të vrarëve në periudhën 8 nëntor 1941-29 nëntor 1944, të cilët nuk kanë qenë juridikisht në shërbim të shtetit shqiptar.
- T’u njohë statusin e dëshmorit të gjithë të vrarëve nga komunistët (ose formacione të tjera të armatosura) në periudhën 8 nëntor 1941-29 nëntor 1944, të cilët kanë qenë ligjërisht të ngarkuar në shërbim të institucioneve shtetërore, civile ose ushtarake.
- Të caktojë një datë përkujtimore për të rënë në luftën civile.

DREJTORI EKZEKUTIV

ÇELO HOXHA



